

# Numërimi i popullit 1918.

Për me vërtetuem e me venduem, mbas grafikës gjendjen e tashme të popullit në Shqipërisë mbas kombësis, besimit e shpeshhtësis (dendësis) së banorëve të mënyre t'urdhnit t'A. O. K. Gstbs. Nr. 1496 me 17. Korrik 1917, urdhnohet numërimi i përgjithshëm i popullit për rrethet e të gjitha Bezirkskomandave e Ekspositurave p. e mb. Numërimi do të kryhet i përkrahëm me vendimin e Korpskomandës XIX. E. V. Nr. 1700/XIII me 11. X. 1917 që flet mbi të caktuem e mbiemnavet (llagapvet) në gjuhën shqip.

## I. Organizimi i numërimit të popullit.

Mbas këtij urdhni po vendohet:

1. Për rrethin e P. T. do t'emnohet së më parë një **Komisari i Bezirkut** për numërim të popullit tue u kujdesun për s'atë mandet që këjo zyre t'i ipet Referentit të Statistikes s'atyshme.

Më tuije për secilin qark (nenprefekturë) do t'emnohet një **Komisari qark** (nenprefekturë). Këjo zyre t'i ipet në asht se mundet një oficeri nenurdhës. Gjithashtu do t'emnohet një **Komisari numërimi** për se cilën Bashkë, në qoftë si nuk asht mungesë nëpunësash.

Si Komisarë numërimi mund t'emnohen Oficera, Fenriba e Kadetaspiranta (Oficera p. e mb. apo shqiptarë).

2. **Komisari i Bezirkut** do t'organizojë numërimin e popullit në rreth të P. T., si edhe do t'u nipi mësimet e nevojshme me gojë Komisarvet të qarkut mbi detyrat e tyre. Komisar i Bezirkut do të jetë përgjigjës si për zbatimin e rregullshëm të këtij urdhni, ashtu edhe për rjedhjen e mbarë të numërimit të përgjithshëm të popullit në rreth të P. T.

**Komisari i qarkut** (nenprefekturës) do t'organizojë numërimin e popullit të qarkut të tij e asht edhe përgjigjës për zbatimin e mbarë. Komisar do të ketë kujdes të madh për të zgjedhun e për të mësuem Komisarët e numërimit; pse pa qenë këta të mësuem e të stervitun mirë, e shumta e shkoqitjevet, sikur se kërkohet në shtyllat e radhjet të numërimit, kishte për të dalë krejt e pa frytë. Nji i tillë mësim mund të bëhet vetëm me nji të mësuem me gojë a më mirë tue bëm nji provë numërimi mbi popull të rrethit të Bashkis qendrore të vendit. Për këtë arsye nuk mund të shtihet në punë nji Komisar numërimi, që të mos jetë i mësuem përpara mbi detyrat e tija nga ana e Komisarit të qarkut. Komisar i qarkut do t'i api secilit Komisar numërimi nji radhë (listë) të visevet të krahinës së numërimit, në të cilin do të jenë të shenjuome shqip ndë nji mënyrë të pagabueshme vendet e pjesët e tyre: Gjithashtu do t'i ipen secilit Komisar numërimi, kôpjet e radhjet të shtëpijave të krahinës për të cilën do të bëjë numërimin.

3. Radhjet e numërimit që vinë nga ana e Komisarëve do të shqyrtohen me kujdes prej Komisarit të qarkut e, në qoftë nevoja, do të ndreqen apo të shlohen tue bâmun shkoqitje të reja; veç kësaj do të ndahen mbas krahinave të numërimit e të Bashkinave e do t'i paraqiten P. T. me nji pasqyrë të përmbledhun shkurt të qarkut, bashkë me nji raport të shkurtë mbi rjedhje të numërimit.

Nuk ka kurrfarë kundërshtimi që Komisar i qarkut të veprojë si Komisar numërimi ndë nji apo më shumë bashkina. Për arsye mungese nëpunësash, të kryem e numërimit të popullit, mund t'i ngarkohet Komisarit të numërimit në dy a shumë bashkina.

**Komisari i numërimit** përbën bashkë me Drejtorin shqiptar të Komissis për të vuemt e emnavet — për të cilën flet urdhni i Korpskomandës E. V. Nr. 1700/XIII me 11./X. 1917 (Mudyr ase nepunës i tij) e me sekretarin shqiptar, Komisin e numërimit të popullit; Komisar i numërimit asht si kontrolluer përmbi Drejtorin shqiptar të Komissis.

Por së t'arrije Komissija ndë nji vend të krahinës së numërimit, Komisar i numërimit bashkë me pjesëtarët e tjerë të Komissis si edhe me të parët e pleqt e vendit, do të vërtetojë tue përdorue radhjet e vendit e të shtëpijave, në s'atë pjesë ndahet vendi e s'atë shtëpia ka secila pjesë e vendit.

Në mënyrë të këtyne shkoqitjeve do të caktohet plani i të kryemit të numërimit apo i të vuemit të emnavet n'atë vend. Po në atë kohë, do të vertetohet në këtë këshill se sa janë ndertesa botore, zanati, industrije e besimi n'atë vend (ndertesa zyrtare, kazerma, spitale shkolla fabrika, mulltj, fabrika tjegullash, kishá, kuvende xhamija etj.).

Kúr Komisija shtegtare (shëlitëse) të jetë plotësue me të parët e me pleqt e vendit e, me të parët e e besimit e, keshtu, të jetë bëmë një Komisi vendi, do të thirren të parët e famillevet vetmas, të cilëvet do t'u caktohet emni i familës (llagapi) mbas urdhnit të Korpskomandës E. V. Nr. 1700/XIII me 11./X. 1917; Komisari i numërimit do të kujdesohet qi shtyllat e emnavet 4, 5 e 6 të radhojvet të numërimit të mbushen mirë.

Mbas urdhnit të Korpskomandës qi përmendet aty-sypër, Komisari do të marrë influencë në veprim të të vuemit t'emnavet vetëm për të ndaluem mungesa të mdhaja qi i kundershtojne urdhnit të mbram e qi shkatojnë një rredhje të kadalshme të veprimit në të vuem të emnavet. Kúr të mbarohet veprimi me të mbushunt e të tri shtyllatvet t'emnavet, atëherë, mbas mënyrës së këtij urdhni, registrohen diftimet vetijake të kryetarit të families ase të mbarshtrimit të shtëpis s të pjestarvet të families apo të njerzvet qi qinden nen urdhen të tij.

Po që, se sekretari diftohet se s'është i zoti për shkrim, atëherë Komisari vetë do të bájë regjistrimet në radhojt e numërimit, mbasi ai është pergjigjës për secilin regjistrim mbas rregullës qi. u tregue.

P. T. do të kryejë sá má parë organizimin e numërimit të popullit, tue i diftue Korpskomandës emnat, ranget e Komisarit të Bezirkut, Komiservert të qarkut e të piesetarve shqip-tarë të komisis; veç kësaj do të propozojë një shpërbllim për Komisarët e numërimit e do lajmojë me pakë fjalë mbi planin e zbatimit.

Nder ato vende të Bezirkevet të Shkodrës, Beratit e Zhurit, kú mbas urdhnit të Korpskomandës E. V. Nr. 3249 me 31./VII. 1917 janë kryem numërimet e popullit mbas rregullës e ndergjegjes, munden m'u marrë në kujdes regjistrimet e radhojvet qi janë bëmë në rasë të këtij numërimit. Landa e këtyne regjistrimevet do të kontrollohet e do të plotsohet. Emnat do të caktohen në mënyrë të radhojvet të bëmë rishtas.

Si ditë e fillësës të numërimit të popullit caktohet 1 Mars 1918.

## II. Vendime zbatimi.

### 1. Njerz ushtarë austro-ungarë

a se të fuqivet besëlidhuna, si edhe rob lufte, nuk do të shtihen në numërim.

### 2. Numërimi i radhojvet.

Radhojt e numërimit të popullit të perdornem në një vend, do të numërohen në krye me numër renduer e në secilin vend per t'u numëruem do të fillohet me numërin 1.

### 3. Kryet e radhojvet.

Në krye të secilit radhue do të shenjoht me kujdes të posatshtëm emni i vendit, si edhe i Bashkts.

### 4. Regjistrime ndertesash.

Po u gjeten në vend ndertesa botore, zanadi, industrije a besimi, do të shenjohten në krye të radhoit të posatshtem per numërimin e vendit, me numërin 1 b. fj. 1. Kazerm Gjendarmertje, 1 shkollë, 4 mullt një, 1 kishë katolike, 1 xhami.

### 5. Pjesët e vendit.

Në shtyllë të parë të radhojvet do të regjistrohet kurdoherë pjesa e vendit e nder qytete (Mehalla e rruga a se rrugaca).

Kujdes të posatshtëm duhet me pasë për shkrimin e të gjitha pjesëvet të vendit për me mujtë, me shtuëm apo me ndrejtue radhojt e vendit e me përsëritë emnat e tyne n' orthografin shqipe.

### 6. Numri i shtëpis.

Në shtyllë 2 do të shkruhet numëri i shtëpis. Po që qi ndodhen numra shtëpijash të gabuëshnë, do të ndreqen sá të mundet e do të bëhet një shenim në shtyllën 2.

### 7. Numri renduer i mbarshtrimevet të shtëpijave

do të regjistrohet në shtyllën 3. Të gjith banorët e një shtëpije qi përbajnë një mbarshtrim të perbashkët, do të përmbldhen nen kuptimin mbarshtrim shtëpije. Nder qytete, ku ipen shtëpija

me qira, munden me qillue në një shtëpi shumë mbarshtrime shtëpije njëni mbas tjetrit; në këtë rast kuptimi i mbarshtrimit të shtëpis është baras me kuptimin e familjes. Regullisht ndër katunde qilloh vetëm një mbarshtrim shtëpije d. m. th. ai i të zotit, bulkut apo i regulluesit të cilët munden m'u qërbëem prej familjes së tij. prej familjeve të bijve apo t'afëris, (ilakave) si edhe prej familesh të shërbtorëve të tij.

Njëz të zotit e fitimit që jetojnë vetmas h. fj. nëpunës të pamartuëm. mësues, shërbtorë atj., të cilët banojnë në një shtëpi si qiraxhi e që ushqimin e marrin prej ndonji vofre (Messe) apo prej ndonji hoteli ase i gatujnë haenat (ngranjet) vetë. do të shënjohen si mbarshtrues shtëpije më vete.

### 8. Regjistrimi i emnave.

Në shtyllën 4 do të shkruhen mbiemnat e të gjithë njerzvet, në shtyllën 5 do të regjistrohet emni i të zotit të familes, emni i shtëpis, fushës apo llagapi; po që se nuk ka kush mbiemën, atëherë do t'i regjistrohet emni i babës apo i gjyshit të tij ase mbiemni që i është bërë emën famileje se të zotit të shtëpis që i është vënë nga ana e Komisis. Të gjitha regjistrimet e emnave do të nodhin në një mënyrë shkrimi të kjarhtë që të mundet të këndohet Përiestarët e të Zotit të familes do të mbushen shtyllat 5 e 6 me nga një pikë.

### 9. Gjendja ndermjet të mbarshtruesit apo të Zotit shtëpis.

Në shtyllën 7 do të shënjohet mbarshtrësi i shtëpis si i tillë tue u regjistruer mbarshtrues shtëpije, veç kësaj do të shënjohet në këtë shtyllë gjendja e kushtrinis (afëris) e e shërbimit ase ç'farë do tjetër gjendje e zotëve të famileve me mbarshtruesin e shtëpis apo të pjesëtarëve të familes me të Zotin e shtëpis. (Shiko mostrën në shtesë!)

### 10. Të pyetunt e mbarshtrësit të shtëpi.

Nder vende ku shtëpijat janë numëruë do të pyeten mbarshtruesit e shtëpive mbas rendit të numrit të shtëpis.

Pikë së pari do të regjistrohet mbarshtruesi i shtëpis, pastaj tjerët zota shtëpije apo njerëz që banojnë në shtëpi të tij. Po që se disa zota shtëpije nuk duken përpara Komisis, atëherë Komision do të bëjë pa vanesë hetimet e nevojshme për ata që mungojnë.

Për këta, veç anëtarëve të familes, do të pyeten miqt (shokët) e shtëpis, fqijt si edhe të parët e besimit e pleqt e vendit që gjinden n'atë komisi.

### 11. Ndeshkimet.

Komision do t'u diftojë njerzvet që duken para saj, se diftimet e padrejta do të ndeshkohen rrebtësisht.

### 12. Gjinja

do të shënjohet në shtyllat 8 e 9.

Të gjithë burrat pa ndryshim moshet do të duken para Komisis.

Në qoftë, se në kohë të numërimit shumë burra nuk regjistrohen me qellim që të shpëtojnë prej angariës e prej shërbimit ushtarak, sikurse pat qilluëm herën e parë do t'u bëhet me dije të parëve e pleqvet të vendit, që këta e kanë për detyrë me i a diftuëm Komisarit të numërimit me një herë këta njerëz Komision mund t'urdhnojë të sjellunt e këtyne me forcë, po që që këjo punë mund të kryhet pa humbë kohë; perndryshej të pramt e këtyne mund të ndodhi më vonë para Mydyrit, do të ndeshkohen si mbas randësis që fajit me 20—100 Kuna gjobë.

Të dukunt e emnave para Komisis kishte me qenë punë e dishrueme, por nuk mundet me pasë shtrëngim për këtë, po që se njerëz e tyne kundërshtojnë për arsye besimi; në kësi rasash komision do të miaftojë me ditime e të zotëve të shtëpis së tyne.

### 13. Diktimi (sbulimi) i moshës

është i vështirshëm tue qenë se shumica e popullit nuk e din moshën e vet.

Prej landës së numërimit të popullit që u krye vjeten që kaloj shifet se diftimet e moshës së mohamedanëve janë shumë më të pa besueshme se ato të krishtenëve mbasi moshë e këtyne mundet m'u diktue prej amzavet (nofuseve) kishatare, pastaj diftimi i moshës së meshkujve është më i pa besueshëm se i gravet, se burrat më njënë anë mundohen me e shtj kohën e detyrës së puntoris e të shërbimit ushtarak, e diftojnë një moshë tepër të ré, e më

tjetrën anë për me u shmangë këtyne detyrave për gjithmonë dittojnë një moshë tepër të motshme.

Organet (nëpunësat) e numërimit, që janë të squet e të marrun veshit në punë, kanë për të paem me një herë në mbarim të numërimit në një vend, mbassi të kenë bëmë një të përmbledhun e të përkrahun të klaseve të moshës mashkullore prej 1-10, 11-20, 21-30 e 31-40 vjetsh, se mos difton klasi i moshës prej 21-30, që është më i kritikshmi, një numër tepër të vogël në të përkrahun me klase tjera.

Për me mujtë më njenën anë me diktue m mirë moshën e më tjetrën anë me i bëmë bati me fryt dittimevet të shtrembëta, Organet e numërimit do të kenë kujdes e ndergjegje të madhe në regjistrim të moshës, mbassi diktimi (sbulimi) i moshës është i nevojshëm për shumë kerkime të mbashtrimit qeveritar.

Shpesh herë qëllon që gratë diftohen si femë ase më të motshme se janë, apo nuk diftohen aspakë.

#### 14. Vendi i lindjes.

Po që, se vendi i lindjes nuk është një vend i njoftun prej gjithkuj si b. fj. Shkodra, Durci, Tirana etj., do të shenjohe përherë edhe Bezirku (Qarku) e për vende të perjashtme edhe Shteti.

#### 15. Shtetsija (tabi-ijeti)

do të vertetohet vetëm për ata të përjashtëm që nuk kanë të ngulun në vend.

Njerëz t'ardhun, që nuk janë shtetas shqiptarë, të cilët kanë ngulë vend si zota tokësh a si tregtarë para shumë vjetsh janë për t'u njehë (numëruem) si shtetas shqiptarë, në qoftë se nuk diftojnë ndonji kundërshtim për këtë punë.

Në këtë rasë do të regjistrohet vendi prej kahë kanë ardhë, do të shenjohe b. fj. i ardhun prej Bosnje.

#### 16. Besimi.

Pë punë të besimit do të shenjohe dāmas (veç e veç) Katolik-romakë e Grekët e bashkuem; e ashtu Orthodhoksët oriental, Orthodhoksët Grek, Serb a Bulgarë (Eksarkist)

Degës mohamedane të Bektashivet do t'i epët një kujdes i posaçëm.

#### 17. Kombësija e popullit.

Si kombesi do të njihet ajo që difton i pyetuni.

E vështirë është kejo punë ndër mohamedanë sllavë, të cilët më të shumën e herës nuk mundin t'a dajnë kombësin kah besimi e, keshtu, diftohen në të tilla rasa „Turq“. - organet e numërimit do të vertetojnë se ç'farë gjuhet flet i tilli në shtëpi. (serbisht, bulgarisht, maqedo-bulgarisht).

Për t'u vuem 'roce është se vllëht e thrrasin vedin edhe zinzar e Aramun

Gabelt (arixhiit) të shenjohe përher Gabela ase Arixhiit edhe në qoftë se gjuha e tyne është shqipja.

Gjithashtu do të bahet ndryshim ndermjet të gabelvet të ngulun (magjup, evgjii, jevg), e të gabelvet shtegtare (gabel, arixhiit, të cilët në Shqipni të mesme quhen edhe evgjii e jevg).

#### 18. Ditunija e shkrimit.

do të shenjohe në shtyllat 17 e 18 d. m. th. a din me shkruem latinisht apo turqisht.

#### 19. Gjendja e familes

Për punë të gjendjes së familes është për t'u vuem oroe që mohamedanët kanë të drejtë mbas Rritit hanefitit me marrë më tepër se një grue, por jo ma shumë se katër.

#### 20. Degat bulqore.

Për veç dittimeve vetijake, deshirohet me u dijte në radhue ndër shtylla 19,22, edhe Degat bulqore. Për këtë arsye Organet e Regjistrimit do të kujdesohen me vertetuem trajtat (format) më të nevojshme të gjendjes bulqore në Shqypni. Vështrim të posatshem kërkon vertetimi i klasit të ndermjetshëm në shtyllen 20 (katundarë që punojnë tokë të veta e tokë të marruna me qirā). Në shtyllen që i perket, do të shkruhet shifra 1 e në tjerat shtylla ka një pikë.

Për zotat e shtëpijave për të cilët janë shtyllat 19-22, shtyllat 24 e 24 do të mbushen me një pikë.

#### 21. Dega që nuk i përkasin bulqsis.

##### a) Zanati kryesuer (principal, bashlixhe).

Në shtyllen 23 do të shenjohe sa më kjarë që të mundet zanati kryesuer prej të cilit vaaret jetesa a se varidati më i madh i atij njerit.

### **Pra do të regjistrohet:**

1. për zyrtarë e tjerë nëpunës botënorë dega e punësis së tij b. fj: Nëpunës gjyqi, financë, banke, mësues, prift, postaxhi, policë Periimtarje, rojtar fushe etj.
2. për tregtarë, zanatçi e nëpunës udhëmësa të tyne, dega e tregtis e e zanatit etj. b. fj. tregti duhanit, tregti drithit, tregti lëkurash, farrkëtoje, kundraxhi, opingaxhi, meihanxhi.
3. për shërbitorë, të cilët përdoren vetëm për shërbim shtëpije apo për shërbime vetija-ke do të shenjohe lloji i përdorimit të tyne, b. fj. marshtrim shtëpije, Kavas a qehaja.
4. për argatë, që punojnë gjithfarë punësh, do të përmendet ajo degë punët me të cilën merren më tepër b. fj. puntuer godinaash (binash).
5. Si zanatçi do të njehe edhe grà, në qoftë se kanë një fitim të vetin, b. fj. çamar-shixheshë, lase petkash, hamallice.

### **Puna në zanatin kryesues.**

Në shtyllën 23 do të shenjohe përnjherë edhe puna në atë zanat si edhe gjendja e pa-sunis, e e shërbimit të punës, për me diejtë a punohet aj zanatë në vedit a po jo, b. fj. për njerz që merren me tregti a me zanat do të shenjohe, a janë këta të zotët, do me thanë Drejtorët e pa-mvarun, Drejtorët e dugajës (dyqanit) a të zanatit, apo punëtorë ndimësa të një tregtije të madhe apo mjeshtra, shëgerta, punëtorë, nxansa ase shërbitorë të një dugajës tregtare etj.

Kur ndonji ndër pjestarë të families punon bashkë në zanat të të zotit të families e është i regjistruem në shtyllën 23 tuj u numëruem në degë të zanatit të tij, do t'i shtohet punës së tij edhe shenimi „punon bashkë“.

Ndër rasi ma të shumta shtylla 23 ka për t'u mbushë me një fjalë të vetme, b. fj. msues mjek, postaxhi, kavas, çamashirxheshë lase petkash etj.

### **c) Zanat i dorës së dytë.**

Në qoftë se diktohet një zanat i dorës së dytë b. fj: një bukë është edhe marangoz, atë-herë në shtyllën 23 do të shenjohe „është edhe marangoz.“

## **22. Pa-zanat të caktuëm.**

Për njerz pa-zanat të caktuëm do të shenjohe në shtyllën 24 lloji i punës prej kah vaaret jetimi i tyne, b. fj. Zot shtëpijash (prosietar, akarat sahibi), fajdexhi, lypës, etj.; në këtë shtyllë do të shtihen edhe nxansat e shkollavet normale. Në numërimin e popullit të vjetës që shkoi, shum Zota shtëpijash, fajdexhi, si edhe njerz të pa-pasun e pa ndonji pönë, qenë regjistruëm me titullin „privat“ por kjo nuk do të përsëritet këtë herë.

## **23. Njerz që përkohësisht ndodhen pa-punë.**

Për njerz që gjinden ndër spitale e burgje, si edhe për njerz që për arsye të luftës gjinden pa-punë, do të shenjohe veprimi i punësis së tyne si i ndaluëm përkohësisht.

## **24. Shtyllat 8, 9, 17, 18, 19, 20, 21, 22**

do të mbushen, kur t'a hjerë puna, me shifren 1, e ndër rasi të perkunderta me ka një pikë

## **25. Gërmanisht e shqip.**

Të gjitha regjistrimet do të bahen në gjuhë germanishte e shqipe.

## **26. Të mbyllunt e regjistrimevet.**

Porsa të jenë mbaruëm shenimet për një mbarshtrim shtëpije, do të mbyllen me një vizë të ratë = (shulare, ufki) që të përfshijë gjithë faqen. Mbarshtrimet e shtëpijavet të një vendi do të numërohen në shtyllën 3 me numra rendorë, tuj fillue përherë me shifrin 1.

## **27. Mbas të mbyllunt të numërimit në vend,**

do të nenshkruehen të gjith pjesëtarët e komisis në të mbramen fletë me të cilën është mbyllunt të vuëmt e emnavet e numërimi i popullit (nenshkrin, shëj, të cilët do t'i shtohet emni i Komisarit).

Data e numërit do të shkruhet në një mënyrë të këndueshme.

Pasqyrat e veprimit do të kryhen, në qoftë se mundet, në vend të numërimit, e bashkë me fletat e numërimit të popullit t' atyne vendeve që përpiqen me këtë veprim, do t'i paraqiten Komisarit të qarkut.

# Prapashtesë.

Veprimet e urdhnueme per numërin të popullit e të vuent e emhabet të familëve shqiptare, do të kryhen në mënyrë t' urdhnit të Korpskomandës me 11. Tetuer të vjetit të kaluem E. V. No. 1700 XIII e me 10. Kallënduer 1918, No. 72 sëbashku.

Per plotsimin e ketynë urdhname që po permenden kety-siper po ipen edhe këta vendime:

## Njerëz qi gjinden e qi nuk gjinden në vend.

Populli do të ndahet në banorë (sàqin) qi gjinden e qi nuk gjinden në vend.

I. Si banorë qi gjinden në vend, do të njihen atà qi gjinden ditën e numërimit nder shtëpja të vela, ase ata qi jan largue per një kohë të shkurtë, ma shum per një javë, prej vendit të vet.

Atà njerëz qi banojnë jashta vendit të numërimit, e qi gjinden deri javën tjetër mbas ditës të numërimit po n'at vend, nuk do të numërohen. Atà njerëz qi banojnë jashta vendit të numërimit e qi gjinden ma teper se një javë në vend të numërimit, do të njihen si banorë në vend të numërimit e do të numërohen n'at vend qi gjinden; emnat e tyne do të shenjohen me një vizë e do t'i u shtohet edhe banimi i perbershem b. fj. Kol Frakufa prej Fieri asë Abedin Hoxha prej Pishkopezit.

II. Si banorë qi nuk gjinden në vend, do të njihen anëtarët e families ase të marshtrimit apo ata banorët, qi ditën e numërimit nuk gjinden në vend të numërimit e qi rrijnë ma teper se një javë pa ardhë (b. fj. zanatci qi verës punojnë jashta vendit të tyne, nxansa qi ndjekin një shkollë të përjashtme; banorë qi i perkasin ushtris, punëtori asë Gjindarmeris së vendit etj.)

Edhë njerëz qi nuk gjinden në vend do të regjistrohen nder fletat e numërimit të popullit, por tuj i u shtue emnit të tyne fjala „nuk gjindet këtu“ e banimi; po qe qi banimi (mesqeni) i tyne ndodhet në një vend të perjashtem, do të shenjohet edhe emni i atij vendi.

Kuer mos të diftohet vendi i banimit taman, nuk mund të dihet ma vonë a janë ba regjistrime dyfish (tuj diftue në vend të banimit të perbershem se nuk gjindet e në vend të banimit të perbershem se gjindet).

Emnavet t'atyne anëtarëve të vendit qi gjinden n'ushtri, në puntori asë në Gjindarmeri të vendit do t'i shenjohet per sa të mundet, chargja, emni i formacionit asë orta, si edhe vendi i Stacionit apo vendi ku punon.

Të damit e popullit në popull banuer të perbershem e popull banuer të perkohshem u ja jashtë, per me u letesue punen Komisarvet të numërimit qi kishte me i u shkakëtue prej këtij të damit; në këtë mënyrë unjsohet perfyrimi i popullit qi banon në vend perkohësisht me ate qi banon perherë, tue qenë se të lujtunt e banorvet prej ndonji vendit në një tjetër është, mbas gjendjes të soçme, teper i rrallë.

Ndër ato vise, në të cilat një pjesë e popullit me fillim të prendverës mbaret në bjeshka të larga, numërimi i popullit do të kryhet në fillim e ma së vonit deri në gjysë të Marsit të k. vj.

## Kopje të dyta të fletëve të numërimit të popullit.

Kopjet e dyta të fletëve të numërimit të popullit do të kryhen në mënyrë t'urdhnit të Korpskomandës E. V. No. 1700 XIII, me 11. Tetuer të k. vj. si t'a shofin me arsye P. T. prej Komisivet të numërimit, ase prej sekretarëve qi janë të zotët per këtë punë.

## Dishmina njoftimi.

Per sa t'arrijë landa e numërimit të popullit, dishminat e njoftimit per Zotat e familëvet, t'urdhnueme prej Korpskomandës me urdhen E. V. No. 1700 XIII, me 11. Tetuer të k. vj kan per t'u pregalitë për secilin Bezirk prej Zyres së pergjithshme të Statistikës.

# Moster shembëllet

mbi

## Gaktimet e zbatimit (Pjesa 9).

Numri rëndor i mbarshtrimevet të shtepilavet	Emri	Emri i shtepisë, fushës, mbiemri qesharak e, në qoftë se nuk ka mbi-emën, emri i babës, i gjyshit a po emni i families	Emri i families i caktuen tash (Mbi-emni)	Mbarshtruesi apo i Zoti i shtepis
3	4	5	6	7
		<b>i të Zotit të shtepis</b>		
14	Zef Çile Hil Nusa Zef Luzia Gjon Age Jak Prenna Age	Koka — — — — — Reresi	Koka Koka — — — Reresi	Mbarshtruesi i shtepis e shoqja e tij i biri e shoqja e ketif femijt e keuj Sherbtori i mbarshtruesit të shtepis e shoqja e ketif femijt e keuj
15	Brahim	Skijani	Murati	pa kerend (i veltm)
16	Hatfis Mirjam Abdulla Maje Hamide Musa Fadil Meme Aleme	Sulejman Omeri — — — — — — — Osman Mustafa	Omer — — — — — — — Stafa	Mbarshtruesi i shtepis e shoqja e tij femijt e tij e reja, mbete e vee femijt e saj Sherbtorja e mbarshtruesit të shtepis